



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 2 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-049, për financat e pushtetit lokal (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”nr.27/2008) dhe të dispozitave të nenit 34 paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2021 mori këtë

V E N D I M

PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT PËR TARIFA, NGARKESA DHE
GJOBA KOMUNALE, NR. 01- 431/04-112314/21, DT. 16.06.2021

I. **MIRATOHET** Vendimi për ndryshimin e Vendimit, nr. 01-431/04-112314/21, dt.16.06.2021.

II. Neni II, pika 3.1, ndryshohen shifrat e veprimtarisë:

3511 - Prodhimi i rrymës elektrike.....	1000€
3600 - Grumbullimi i ujit, trajtimi dhe furnizimi.....	1000€
4511 - Shitja e automjeteve të reja motorike.....	700€
4511 - Shitja e automjeteve të përdorura motorike.....	300€
4730 - Shitja me pakicë e karburanteve dhe lubrifikanteve motorikë në shitore të specializuara (zona urbane)	1000€
4730 - Shitja me pakicë e karburanteve dhe lubrifikanteve në shitore të specializuara (zona rurale).....	500€
4646 - Shitja me shumicë e mallrave farmaceutike	500€
4773 - Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutikë (barnatoret).....	250€

5510 - Hotelet.....	1000€
5510 - Motelet.....	300€
5510 - Hostelet	300€
6419 - Ndërmjetësime të tjera monetare (bankat)	1000€
6419 - Ndërmjetësime të tjera monetare (institucionet mikrofinanciare).....	500€
6110 - Veprimtaritë e telekomunikimit (rrjeti fiks, rrjeti mobil).....	1000€
6512 - Sigurimi jojetësor	1000€
8010 - Aktivitetet e sigurimit privat.....	300€
8424 - Rendi publik dhe aktivitetet e sigurisë.....	300€
8020 - Aktivitetet shërbyese të sistemeve të sigurimit.....	300€

- III. Ndryshimi i Vendimit bëhet në nenin 2, pika 3.1.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Sektori për zhvillim të qëndrueshëm.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-431/04-185458/21, më 03.09.2021

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

